



## KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Shërbimi për punë të Kuvendit

01 Nr. 06-5290 /14

Klinë me 15.12.2014

### EKSRAKT-PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XI-te e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 15. 12. 2014 në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën 10:00.

#### R e n d i i d i t ë s :

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për transparencë në Komunën e Klinës,
4. Shqyrtimi i Vendimit për tarifa , taksa dhe gjoba Komunale,
5. Shqyrtimi i propozim-Vendimit të planit Rregullues Urban,
6. Shqyrtimi i propozim-Vendimit të Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021,
7. Shqyrtimi i planit të punës së Kuvendit dhe kalendarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin vijues,
8. Të ndryshme.

Në mbledhje ishin prezent:

1. Dr. Haxhi Ibishi.....Kryesues
2. Ramush Agushi.....anëtar
3. Halil Desku..... anëtar
4. Fadil Gashi.....anëtar
5. Avni Gashi.....anëtar
6. Ndue Shabanaj.....anëtar
7. Pal Berisha.....anëtar

Pjesëmarrës të tjera ne mbledhje ishin: Përfaqësues të OSBE-se, të Zyrës Ligjore të Komunës, Baki Gashi- drejtor i drejtorisë së urbanizmit, mediet e tjera.

Mbledhjen e hapi z. Dr. Haxhi Ibishi i cili pasi i përshëndeti të pranishmit i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje dhe shtoi së pika

e IV-te e rendit të ditës shtyhet me rekomandim të Ministrisë deri në një njoftim tjetër dhe në vend të saj të shqyrtohet Vendimi për tarifa ,taksa dhe gjoba Komunale që është kthyer nga Ministria.

Rendi i ditës me këto propozime u miratua unanimisht nga anëtaret e Komitetit.

#### **Pika e I-re: Arsyetimi i mungesave**

**Dr, Haxi Ibishi** tha së të gjithë anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa janë prezent në mbledhje.

#### **Pika e II-te: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,**

Procesi i mbledhjes se kaluar u miratua unanimisht nga të pranishmit.

#### **Pika e III-te: Shqyrtimi i projekt Rregullores për transparencë në Komunën e Klinës.**

**Ali Shala-** Zyra Ligjore e Komunës tha së ne e kemi pasur një Rregulllore për transparencë qysh nga koha e UNMIK-ut por karshi Udhëzimit Administrativ të MAPL-se jemi të obliguar që ta bëjmë harmonizimin e saj dhe së deri tani kemi pasur probleme në qasje në dokumente zyrtare. Sugjerimet, plotësimet e juaja do i shqyrtojmë bashkërisht e po ashtu edhe sugjerimet qe do të dalin nga debati me publikun do të shqyrtohen dhe do të merren parasysh, ju mund ti bëni vërejtjet apo sugjerimet e juaja edhe me shkrim. Kjo Rregullativë do ti shërbej organeve të administratës publike, kemi metodat me bashkëkohore të qasjes në dokumentet zyrtare, kërkosat bëhen në zyrën për informim të Komunës.

**KPF-ja rekomandon që kjo projekt-Rregulllore të bartet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit.**

**Pika e IV-te: Shqyrtimi i Vendimit për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores Komunale për tarifa, taksa dhe gjoba Komunale sipas rekomandimit të MAPL-se.**

**Ali Shala** tha së ne më parë e kemi shqyrtuar dhe miratuar këtë Vendim por Komisioni Nder-ministror ka rekomanduar që të bëhen ndryshimet dhe plotësimet e këtij Vendimi e krejt kjo për shkak së zyra e shërbimit për punë të Kuvendit i ka dërguar me vonesë Ministrisë, psh në nen 5. Të këtij rekomandimi thuhet së nuk janë bërë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme dhe ne në bazë të këtij rekomandimi do i bëjmë këto ndryshime dhe plotësime.

**Fadil Gashi:** në këtë propozim-vendim defekti është shumë më i madh së që e paraqiti zyrtari Ligjor, koordinimi në mes të drejtorisë së financave dhe shërbimeve të tjera nuk ka qenë në nivel , ne u kemi besuar këtyre shërbimeve dhe kemi votua .

**KPF rekomandon që këto ndryshime dhe plotësime të barten për miratim në mbledhjen e Kuvendit.**

**Pika e V-te: Shqyrtimi i propozim-Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban.**

**Baki Gashi**-drejtor i drejtorisë së Urbanizmit dha disa sqarime për miratimin e këtij Plani dhe shtoi së në mbledhjen e Kuvendit do të jetë prezent edhe hartuesi i këtij plani i cili do të jepi sqarime të detajuara.

**Avni Gashi** tha së Plani Rregullues urban është i një rëndësie të madhe andaj lidhur me këtë mendoi së nuk kemi sqarime të duhura, unë propozoi që të përgatitet një informacion me i detajuar në mënyrë që të dimë pse po votojmë dhe së Kuvendi duhet ta caktoi planin rregullues urban e jo kompania.

**Fadil Gashi:** tha së kjo çështje është me shumë çështje e prokurorisë së sa e jona, ne shkresën e Ministrisë nuk po i shoh fjalët që i tha drejtori dhe së në vitin 2013 ka ndryshua Ligji për Planifikim Urban. Komuna me neglizhencën e saj e ka lejuar vazhdimin e ndërtimeve në dy hapësira që ndalohet ndërtimi, në zonën bujqësore në vitin 2005 kur e kemi miratuar kanë qenë të ndërtuara nëntë shtëpi banimi ndërsa tanjë mbi 110 shtëpi. Për këtë Plan Rregullues Urban çështja e parë që duhet të behët është zotimi i mjeteve financiare sepse kjo ka kosto të lartë.

**Baki Gashi** tha së ne kemi kontaktuar me kompaninë e cila ka punuar edhe me parë dhe do të jap sqarimet e nevojshme.

**Dr. Haxhi Ibishi** tha së Plani zhvillimor Urban është mjaft me rendësi për Komunën andaj mendoi së duhet të përgatiten mirë këto plane dhe nëse nuk jemi plotësisht të përgatitur është me mirë që këto të shtyhen për me vonë.

**Ramush Agushi** tha së unë propozoi që kjo të shtyhet për më vonë dhe të obligohet kompania që të na sjell dokumentacion shtesë.

**Fadil Gashi** tha së Vendimin që është miratuar me parë në këtë Kuvend unë e kamë kundërshtuar sepse ka qenë i falsifikuar dhe mendoi së ka tendencë të rishikimit të procedurave, kompania ka dëshirë që për çdo javë të bëjë ndryshime në planin rregullativ urban sepse ajo përfiton.

**Haxhi Ibishi:** Nëse pajtoheni unë kisha propozuar që ky plan të shtyhet për shqyrtim në ndonjë seancë tjetër me qellim që të përgatiten sa me mirë .

**KPF propozoi që pika e V-te dhe e VI-te e rendit të ditës të shtyhen për me vonë me qellim që këto plane të përgatitën mirë.**

**Pika e VII-te: Shqyrtimi i planit të punës së Kuvendit dhe komiteteve dhe kalendari i mbajtjes së takimeve për vitin 2015.**

KPF rekomandon që kjo pikë të bartet për shqyrtim dhe miratim ne mbledhjen e Kuvendit.

**Pika e VIII-te: Të ndryshme.**

**Dr. Haxhi Ibishi** e lexoi rekomandimin e komitetit për bujqësi.


**Ramush Agushi** tha se unë nuk e dijë së a e dinë anëtaret e këtij komiteti së kjo ka kosto buxhetore.

**Fadil Gashi** tha së unë propozoi që në mbledhjet e këtyre komiteteve të marrin pjesë drejtorët e drejtorive përkatëse.

KPF rekomandon që në mbledhjen e Kuvendit të njoftohen drejtorët që të marrin pjesë në mbledhjet e këtyre komiteteve.

Me kaq mbledhja e KPF-së përfundoi punën në orën 11:15.

Procesmbajtësi,  
Beqir Gashi



Kryesuesi i KPF-se,  
**Dr. Haxhi Ibishi**